

## FILLESAT DIPLOMATIKE NË MARRËDHËNIET SHQIPTARO-TURKE

### 1. Fillesat diplomatike në marrëdhëniet shqiptaro-turke

Shpallja e republikës së re turke dhe ngritja e organeve të reja qeveritare me në krye Mustafa Qemalin, shënojnë fazën e parë të përpjekjeve për një lidhje diplomatike ndërmjet dy vendeve. Ato do të konkretizoheshin vetëm në fillim të vitit 1920, kur u krijuan rrethanat për një marrëveshje diplomatike të mirëfilltë ndërmjet dy shteteve. Në bazë të një marrëveshjeje të mëparshme midis qeverisë së dalë prej Kongresit të Lushnjës (28-31 janar) 1920 dhe asaj turke të drejtuar prej M.Q. Ataturkut, u dërgua në Shqipëri një delegacion ushtarak prej 25 vetash, i kryesuar prej kolonelit të shtatmadhorisë Selahadin Saip Shkoza. Ky komandant me origjinë shqiptare nga Prizreni, sipas porosisë së dhënë nga Ataturku, mori nënshtetësinë shqiptare, u zgjodh deputet dhe gjatë qeverisjes së kabinetit të Iljaz Vrionit 1921-1922 shërbeu si ministër i mbrojtjes kombëtare.<sup>1</sup>

Synimi i qeverisë turke, duke qenë se ishte ende në luftë me Greqinë, ishte të përçante armatën greke duke e sulmuar atë nga dy anë, pra duke hapur një front të ri kundër Greqisë në veri të saj, në kufirin shqiptar. Por, asnjë prej qeverive shqiptare të asaj kohe nuk e përkrahu këtë ide, pasi shteti shqiptar nuk kishte dëshirë dhe nuk shfaqte interes ndaj ideve intervencioniste në një kohë kur statusi i Shqipërisë si shtet i pavarur sapo ishte përcaktuar dhe përpjekjet e shteteve si Greqia e Jugosllavia pranë Fuqive të Mëdha kishin qenë të pandalshme, për të argumentuar se shqiptarët nuk ishin të aftë të krijonin shtet dhe se nuk mund të jetonin në paqe me shtetet fqinje. Për të riafirmuar edhe një herë interesin e Turqisë ndaj shtetit shqiptar, më 1 mars të vitit 1921 Ataturku deklaroi në Asambleshën Kombëtare të Turqisë se: “...*Me popullin shqiptar kemi bashkëjetuar si vëllezër disa shekuj. Prandaj, këtë shtet e komb vëlla do ta ndihmojmë sa të mundim dhe sa të ketë nevojë!*”, më pas thotë: “*Turqia e Shqipëria gjenden në një zonë strategjike në pozita të sigurimit*

*të përbashkët”.*<sup>2</sup>

Nga kjo fjalë e kreut të shtetit turk përcaktohet qartë politika që do të ndiqte Turqia në vitet në vijim përballë shtetit shqiptar. Interesi i shtetit turk ishte që të krijonte një aleancë të ngushtë me Shqipërinë, për të siguruar një pikë të fortë në Ballkan e cila, në rast të ndonjë agresioni grek ose bullgar ndaj Turqisë, do të shërbente si trampolinë sulmesh në kurriz të armikut për ta detyruar këtë të fundit për të bërë luftë në dy fronte. E gjendur përballë këtyre interesave, edhe qeveria shqiptare, e cila e kuptonte fare mirë fleksibilitetin e politikës së jashtme turke, kishte interes që të siguronte një aleat të jashtëm, i cili do të shërbente si pikë referimi dhe ndihme në rast të ndonjë agresioni grek në kufirin e saj jugor. Prandaj, për të hyrë në marrëdhënie konkrete mes dy shteteve, në fillim të nëntorit 1922 Nezir Leskoviku i paraqet Portës së Lartë letërkredencialet e tij si konsull i emëruar i Shqipërisë në Stamboll.<sup>3</sup> Duke qenë se situata politike në Turqi ishte shumë e paqëndrueshme dhe se një qeveri e re tashmë kishte ardhur në pushtet, atëherë, më 18 nëntor të vitit 1922 N. Leskoviku lajmëron se ishte i detyruar që t’i riparaqesë edhe një herë letërkredencialet e tij. Në letrën që ai i dërgon ministrit të Punëve të Jashtme të Shqipërisë në atë kohë, Pandeli Evangjelit, thekson në të njëjtën kohë se edhe pse ai ende nuk është njohur nga pala turke si konsull i Shqipërisë në Stamboll, konsullata do të vazhdojë punën e saj derisa ajo të marrë një përgjigje zyrtare nga pala turke.<sup>4</sup>

Krahas çështjes së njohjes së konsullatës shqiptare në Stamboll, e cila po vononte të njihej prej qeverisë turke dhe po kthehej në një ngërç diplomatik ndërmjet dy shteteve, një tjetër çështje me karakter problematik kishte filluar të shqetësonte qeverinë shqiptare që në atë kohë, gjatë dhe pas Konferencës së Paqes, u quajt “Borxhi Publik Otoman”. Në këtë çështje – që u diskutua gjerësisht në Konferencën e Lozanës – ishin përfshirë pothuajse të gjitha shtetet ballkanike, ndër to edhe Shqipëria. Në politikën shqiptare të asaj kohe u bë një përpjekje e madhe që shteti shqiptar të mos përfshihej në të ashtuquajturin “Borxh Publik Otoman” ose, nëse do të përfshihej, të ngarkohej minimalisht kundrejt dëmshpërblimit që do të duhej të jepte. Më 15 dhjetor 1922, ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Pandeli Evangjeli, i drejtohet me një letër Mehmet Konicës, duke e ngarkuar atë që të shkojë në Foreign Office dhe të kërkojë ndërhyrjen e delegatës britanike në Lozanë në favor të asaj që Shqipëria të mos marrë pjesë në borxhin e Turqisë. M. Konitca ia kthen duke thënë se ishte e pamundur që të takojë Sekretarin e Shtetit për Punët

e Jashtme se edhe ai (Sekretari i Shtetit) merrte pjesë në Konferencën e Lozanës. Sipas Konicës, ishte e pamundur që Shqipëria të mos merrte pjesë në borxhin e Turqisë, por e rëndësishme ishte që, nëse merrnim pjesë, dëmshpërblimi të ishte sa më i vogël.<sup>5</sup> E njëjta gjë kërkohej edhe prej përfaqësuesve të Shqipërisë në Romë e Beograd, që të ndërhynin pranë këtyre qeverive, në mënyrë që të mbështetnin çështjen e mosfutjes së Shqipërisë në pjesën e borxhit të Perandorisë Osmane.<sup>6</sup> Për ta ndjekur këtë çështje nga pranë, në Konferencën e Lozanës shkoi Mehdi Frashëri, i cili mori pjesë në “Komisionin e Çështjeve Ekonomike dhe Financiare”. Më 19 dhjetor 1922 ai mori fjalën dhe, ndër të tjera, kërkoj prej vendeve që merrnin pjesë në komision, që Shqipëria të mos ngarkohej me këtë borxh, pasi ajo kishte qenë një vend i pushtuar dhe, ashtu si vendet e tjera ballkanike, nuk kishte pse të paguante borxhin e pushtuesit.<sup>7</sup>

E teksa në Lozanë diskutohej mbi borxhin publik që kishte Perandoria Osmane, popullsia shqiptare e Izmirit i ishte nënshtruar një presioni të vazhdueshëm. Të rinjtë shqiptarë merreshin dhe dërgoheshin ushtarë, ndërsa familje të tëra shqiptare shkëmbeheshin ose dëboheshin si ortodoksë grekë, me arsyetimin se nuk kishin dokumente identifikimi. Dokumentet që kishte lëshuar konsullata e Stambollit, nuk njiheshin, me pretekstin se kjo konsullatë ende nuk ishte njohur zyrtarisht prej qeverisë turke. Më 22 dhjetor 1922 N. Leskoviku i drejton një thirrje qeverisë shqiptare që të ndërhynte me të gjitha mënyrat, duke i kërkuar qeverisë italiane mbrojtjen e popullsisë shqiptare që jetonte në Izmir, për t’ia adresuar këtë çështje përfaqësuesit italian të atjeshëm.<sup>8</sup>

Gjatë fillimvitit 1923 çështja e njohjes së Konsullatës shqiptare në Stamboll mori një rëndësi të veçantë për vetë arsyen se midis dy vendeve ende nuk po gjendej një rrugë e përbashkët komunikimi, gjë që çonte drejtpërdrejt në mungesën e marrëdhënieve diplomatike. Nga fundi i muajit shkurt, N. Leskoviku, në takimin që pati me Komisararin e lartë të Stambollit, i paraqiti këtij të fundit letërkredencialet me të cilat ishte pajisur prej qeverisë shqiptare, por Z. Adnan Beu nuk pranoi ta njihnte, pasi dokumentet i drejtoheshin Portës së Lartë dhe jo qeverisë së re. Kjo gjë jepte të nënkuptohej se Ankaraja nuk do t’i njihnte marrëveshjet e nënshkruara më parë prej Portës së Lartë. Rrjedhimisht, ajo nuk do të njihnte as Konsullatën shqiptare në Stamboll, derisa të paraqiteshin letërkredenciale të reja, drejtuar qeverisë së Ankarasë, “*Turqia byjyk millet mexhlisi*”.<sup>9</sup>

Më 14 maj 1923 Z. Blinishti lajmëron Tiranën se ishte takuar me Ismet Pashën në Lozanë për të siguruar njohjen e Z. Nezir Leskoviku si konsull i Shqipërisë në Stamboll. Sipas Ismet Pashës - lajmëron ai, - qeveria shqiptare duhet t'i drejtohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Turqisë. Sipas burimeve të tjera që jep Z. Blinishti, qeveria e Ankarasë nuk e ka njohur ende konsullatën shqiptare (në Stamboll) zyrtarisht, pasi në mes qëndron çështja e popullsisë shqiptare që jeton në Turqi.<sup>10</sup> Gjatë muajit maj shtypi turk botonte artikuj të ndryshëm në të cilët proklamonte hapur mendimet e qeveritarëve turq mbi atë se çfarë qëndrimi duhej të mbante shteti turk ndaj atij shqiptar. Në një gazetë turke, vali i Stambollit deklaronte hapur duke thënë: *“Me qenë se Qeveria nuk ka ndonjë marrëveshje zyrtarisht me Shqipërinë, s’mundm të njoftim nënshtetas shqiptar...”*. Këto fjalë të valiut të nesërmen u përsëritën në një formë tjetër prej këshilltarit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Ankarasë: *“Me Ballkanasit Turqia mas Paqes dot meret vesh. Shqipnia në Angora nuk ka përfaqësues dhe Turqia në Shqipni nuk ka derguem...”*<sup>11</sup> Kështu u kuptua dhe u pa qartë se Turqia, përpara se të mbyllte marrëveshje diplomatike me shtetin shqiptar, kërkonte që të mbyllte në fillim çështjen e nënshtetësisë së popullsisë shqiptare në Turqi në favor të saj dhe pastaj të binte dakord me qeverinë shqiptare.

Në mesin e muajit qershor 1923, përfaqësuesi i Shqipërisë në Beograd, Ali Riza Kolonja, i shfaqti përfaqësuesit të atjeshëm turk, Xhevat beut, dëshirën e qeverisë shqiptare për të hyrë në marrëdhënie diplomatike me Ankaranë. Pas bisedimeve që ata patën, u ra dakord që ndërmjet dy qeverive të nënshtetësisë së popullsisë shqiptare në Turqi në favor të saj dhe pastaj të binte dakord me qeverinë shqiptare.

Pikërisht për hir të këtyre pozitave dhe prej kërkesës së mësipërme, në 15 dhjetor të vitit 1923 në Ankara ndërmjet dy shteteve u firmos Traktati i Miqësisë, sipas së cilit midis dy vendeve do të vazhdonte paqja, dashuria dhe miqësia. Njëherazi, traktati do të simbolizonte dhe do të shërbente si shenjë e nisjes së marrëdhënieve, të cilat kishin si pikënisje kërkesën e bërë prej palës shqiptare. Shtypi grek e shikonte këtë afrim si një komplot shqiptaro-turk kundër Athinës. Gazeta greke “Amalthia” e datës 20.10.1923 njofton mbi afrimin shqiptaro-turk duke thënë se, akoma pa u vendosur relacionet greko-turke, Ankaraja bën plane sulmi dhe aleanca armike kundër Greqisë. Pas tentativave për afrim me Bullgarinë, tani gjenden në rrugë afrimi me fqinjën tonë të veriut, Shqipërinë, e cila, sado e vogël dhe e dobët që të jetë, gjithnjë mund të krijojë shqetësime.

Në fund, gazetari e mbyll artikullin me pyetjen: *“Në çfarë konsistojnë këto marrëveshje midis dy shteteve musullmanë dhe që kanë qëndrim armiqësor kundrejt Greqisë?”*<sup>13</sup>

Delegacioni shqiptar, më 1 nëntor zhvilloi një takim me Ismet Pashën, Kryeministër dhe ministër i Punëve të Jashtme të Turqisë, i cili e priti delegacionin shqiptar me një respekt të madh. Në fjalimin e tij, Ismet Pasha tregoi ndjenjat miqësore të Turqisë drejt Shqipërisë dhe shtoi se interesat e Turqisë e lypin që Shqipëria të konsolidohet dhe të forcohet në Ballkan.<sup>14</sup>

Pala shqiptare u kryesua në këto takime prej Eshref Frashërit, në cilësinë e kryetarit të parlamentit shqiptar si dhe prej Xhafer Vilës, në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë.<sup>15</sup> Të dy vendet pranuan të lidhin marrëveshje dhe të hapin zyra diplomatike dhe konsullata. Në të njëjtën kohë, filluan bisedimet edhe për një nënmarrëveshje kombësie, në të cilën do të përcaktohej qartë nënshtetësia e popullsisë shqiptare e vendosur në Turqi prej kohësh, si dhe njohja e pasurisë që ata kishin pasur në vendet e tyre dhe asaj që kishin tashmë. Por, kjo pikë u kundërshtua prej delegacionit turk, i cili ishte vetëm për dhënien e të drejtës së zgjedhjes se çfarë nënshtetësie do të mbanin shqiptarët e ardhur në Turqi pas Luftës Ballkanike. Duke qenë se delegacioni shqiptar nuk tërhoqej nga kjo çështje, u mendua që për momentin të gjendej një rrugëzgjdhje tjetër dhe bisedimet të ndaleshin.<sup>16</sup> Udhëzimet e mëvonshme që erdhën prej Tiranës zyrtare, ishin që t’i hapej rrugë marrëveshjes dhe ajo të firmosej, prandaj, edhe pse delegatët shqiptarë nuk arritën atë që dëshironin në lidhje me këtë pikë, pranuan marrëveshjen dhe e firmosën atë më 15 dhjetor.<sup>17</sup> Më 3 dhjetor delegacioni shqiptar u nis drejt Tiranës, ndërsa Ministria e Punëve të Jashtme njoftonte qeverinë shqiptare se marrëveshja u nënshkrua në të gjitha pikat.<sup>18</sup>

Pak kohë më vonë, nga Mustafa Qemali u caktua si përfaqësues i palës turke në Shqipëri Tahir Lutfi beu. Ndërsa për palën shqiptare në Turqi nuk u vendos asnjë përfaqësues, për vetë faktin se si rrodhën ngjarjet në Shqipëri gjatë qershorit 1924. Po ashtu, për shkak të situatës së rënduar, marrëveshja e 15 dhjetorit nuk u ratifikua prej parlamentit shqiptar, ratifikimi i kësaj marrëveshjeje do të bëhej gjatë shkurt-marsit të vitit 1925. Një muaj më vonë, më 6 prill 1925, atë e ratifikoi edhe parlamenti turk.

Më 19 prill të vitit 1925, kur Asambleja Kombëtare e Shqipërisë sapo e kishte shpallur Republikën, Ahmet Zogu i dërgonte këtë letër Atatürkut, i cili, pak kohë më parë, më 29 tetor 1923, e kishte shpallur Turqinë Republikë:

I nderuar President,

Në Ankara pra brenda republikës tuaj është formuar një grup i përbërë nga parlamentarë që do të ndjekin vazhdimësinë e marrëdhënieve sipas Protokollit të firmosur nga të dyja palët me anë të cilit u rivendos miqësia dhe dashamirësia mes dy popujve tanë.

Duke shfrytëzuar këtë moment të rëndësishëm me sinqeritet dhe nga zemra dua të uroj popullin heroik turk i cili megjithëse ishte në një gjendje shumë të vështirë arriti me sukses të çonte deri në fund këto ndryshime kaq të vështira dhe të rëndësishme. Me anë të kësaj letre kam dëshirë që t'ju dërgoj përshëndetjet dhe urimet e mia më të sinqerta.

Lidhjet e përsosura të përbashkëta mes popujve tanë në të shkuarën kanë vërtetuar miqësinë tonë dhe shpresoj që me anë të këtyre marrëveshjeve në historinë e të ardhmes të shkruhet për miqësi e paqe.

Ju lutem pranoni përgëzimet e mia dhe, edhe një herë dërgoj përshëndetjet më të sinqerta e respektin tim.<sup>19</sup>

Dukej sikur rruga e dy shteteve, edhe pse me diferenca të ndryshme, do të ndiqte të njëjtin orientim. Nganjëherë dukej sikur Shqipëria do të ndiqte rrugën e Turqisë, por kjo nuk ishte e thënë. Brendapërbrenda elitës politike shqiptare pati prej atyre që ishin kundër ratifikimit të marrëveshjes shqiptaro-turke. Ndër ta mund të përmendim Ali bej Këlcyrën i cili deklaronte se çfarëdo lidhje ose marrëveshje që do të bënte shteti shqiptar me Turqinë, do të ishte në dëm të popullit shqiptar i cili aspironte zhvillimin dhe progresin perëndimor dhe jo orientalizmin e shkuar. Këto mendime të tij ai i kishte bërë publike që në vitet 1921-1922.<sup>20</sup> Opozita e krijuar brenda parlamentit shqiptar, për të ndalur rilidhjen e marrëdhënieve diplomatike dhe politike midis Turqisë dhe Shqipërisë, nuk pati mbështetje dhe jehona e saj nuk gjeti përkrahës. Kjo vinte për shkak se pas dhjetë vjetësh pavarësie shteti shqiptar kishte hasur në pengesa të vazhdueshme, të cilat ishin krijuar dhe frymëzuar prej dy shteteve fqinje, Greqisë dhe Jugosllavisë. Në këto kushte, ndihej nevoja e një aleati të jashtëm. Në të njëjtën pozitë ishte edhe qeveria e

Ankarasë, e cila, pas ristrukturimit të organeve qeveritare dhe abrogimit të sulltanatit, kërkonte të ruante lidhjen me etnitë e ndryshme që kishin qenë më parë nën sundimin e Perandorisë Osmane, një ndër këto etni ishin edhe shqiptarët.

Në kuadrin e dëshirës dhe punës për të krijuar një traditë të mirë bashkëpunimi mes dy shteteve të sapoformuara, që nisi në fillim të viteve njëzetë, do të vihej re një plasaritje e cila do të fillonte në janar të vitit 1923, kur Greqia dhe Turqia nënshkruan në Lozanë një marrëveshje për shkëmbimin e popullsisë. Edhe pse të dy palët ranë dakord që nga kjo marrëveshje të përjashtonin popullsinë shqiptare (çame) që jetonte në Greqi, përsëri, si Athina, ashtu edhe Ankaraja nuk iu përmbajtën zotimeve të tyre. Nëse qeveria e Athinës shfrytëzonte rastin për të hequr qafe pakicën shqiptare muslimane brenda kufijve të saj, qeveria e Ankarasë kishte arsye të forta të favorizonte një shkëmbim të tillë. Së pari, ajo kërkonte të rivendoste sadopak numrin e popullsisë që kishte pësuar humbje të mëdha gjatë luftës me Greqinë dhe, së dyti, pasuritë që linin pas të mërguarit, futeshin në llogaritë përfundimtare midis dy qeverive.<sup>21</sup> Të njëjtën frymë dhe qëndrim ndaj popullsisë çame ruajti përfaqësuesi turk në komisionin mikst, që u krijua për të hetuar dhe shqyrtuar shkëmbimin e popullsisë, duke mos i tërhequr vërejtje qeverisë greke për dhunën sistematike dhe shkëmbimin e popullsisë shqiptare që jetonte në Greqi, si dhe duke mosbashkëpunuar me qeverinë shqiptare për të parandaluar këtë gjenocid. Kjo politikë e ndjekur prej Ankarasë bëri që në marrëdhëniet mes dy vendeve të krijohesh një frymë mosbesimi, e cila do të zgjaste për disa kohë.

### Shënime:

<sup>1</sup> Nexhip P. Alban & Nesip Kaçi, Shqiptarët në Perandorinë Osmane, Tiranë: Albini, 1997, f. 17, 167.

<sup>2</sup> N.P. Alban & N. Kaçi, vepër e cituar, f. 18.

<sup>3</sup> AMPJSH, F. 151, V. 1922, D. 98, f. 1. (datë 11 nëntor 1922)

<sup>4</sup> AMPJSH, F. 151, V. 1922, D. 98, f. 3. (18 nëntor 1922)

<sup>5</sup> AMPJSH, F. 151, V. 1922, D. 103, f. 94.

<sup>6</sup> AMPJSH, F. 151, V. 1922, D. 103, f. 95.

<sup>7</sup> AMPJSH, F. 151, V. 1922, D. 103, f. 113. Procesverballi Nr. 619, dhjetor 1922. Konferenca e Lozanës mbi punët në Lindjen e Afërme. Komisioni i Cështjeve Ekonomike dhe Financiare.

<sup>8</sup> AMPJSH, F. 151, V. 1922, D. 103, f. 153.

<sup>9</sup> AMPJSH, F. 151, V. 1923, D. 199, f. 1-2. (21 shkurt 1923)

<sup>10</sup> AMPJSH, F. 151, V. 1923, D. 199, f. 5. (14 maj 1923)

<sup>11</sup> AMPJSH, F. 151, V. 1923, D. 199, f. 13-15. (Stamboll 18 maj 1923)

<sup>12</sup> AMPJSH, F. 151, V. 1923, D. 199, f. 23.

<sup>13</sup> AMPJSH. F. 151, V. 1923, D. 200, f. 17-19.

<sup>14</sup> AMPJSH. F. 151, V. 1923, D. 200, f. 34.

<sup>15</sup> Gazeta Dita, 5 shtator 2004, fq 12-13, Nexhip P. ALPAN dhe Nesip KAÇI, Ftohja e "babait" të Tuqisë me Mbretin e shqiptarëve, material i përkthyer prej gazetës Baris (turq. Barësh) "Paqja", të datave 15, 16, 17 korrik 1981. Delegacioni shqiptar që u nis për në Turqi, përfaqësohej prej Eshref Frashërit që ishte kryetari i parlamentit shqiptar dhe nga një grup deputetësh.

<sup>16</sup> AMPJSH. F. 151, V. 1923, D. 200, f. 56-57.

<sup>17</sup> Gazmend Shpuza, Ataturku dhe shqiptarët, Tiranë: Dituria, 1994, f. 46-51.

<sup>18</sup> AMPJSH. F. 151, V. 1923, D. 200, f. 66.

<sup>19</sup> ŞİMŞİR Bilal M., Atatürk ve Yabancı Devlet Başkanları, v. 1, Stanboll, 1993, f. 284, material i përkthyer dhe i cituar sipas Anila Polatit.

<sup>20</sup> G. Shpuza, vepër e cituar, f. 38.

<sup>21</sup> Arben Puto, Demokracia e Rrethuar, Tiranë: 8 Nëntori, 1990, f. 148.